

Numri i lëndës: 2020:908288

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05403518

C.nr.764/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Dega në V., Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Alush Sinani, me bashkëpunëtoren profesionale Lumturije Fetahu, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve A.K., K.R., N.I., I.H., M.G., B.E., M.I., L.H., H.H., Dr.F.A., R.P., F.N., A.N., B.B., të gjithë puntorë në Shtëpinë e Shëndetit në V., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit të përbashkët av. E. nga V., kundër të paditurës Komuna e V.-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i Komunës V., A.A., me objekt kontesti; Kompensimi i orëve të punës gjatë kujdestarisë, orëve gjatë natës, orëve jashtë orarit, orëve gjatë festave dhe fundjavëve, vlera e kontestit 47,180.29 euro, pas mbajtjes së seancës kryesore dhe publike të dt.20.02.2024, mori dhe me datë 01.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve A.K., K.R., N.I., M.G., B.E., M.I., L.H., H.H., R.P., F.N., C.D., të gjithë puntorë në Shtëpinë e Shëndetit në V., me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësve t’iu paguaj në emër të kompensimit të orëve të punës gjatë kujdestarisë, orëve gjatë natës, orëve jashtë orarit, orëve gjatë festave dhe fundjavëve dhe atë:

-Paditëses A.K., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,479.30 euro (dymijëekatërqindeshatëdhjetëenëntë euro e tridhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Paditësit Kushrim Rama, për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,137.90 euro (dymijënjëqindetridhjeteshtatë euro e nëntdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Paditëses M.I., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.05.2022, shumën prej 513.19 euro (pesqindetremdhjetë euro e nëntëmbdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8%, në V., prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses M.G., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,684.58 euro (dymijëegjashtëqindetëdhjetëkatër euro e pesëdhjetë e dy cent) me kamatë ligjore prej 8%, në V., prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tësit B.E., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 1,845.96 euro (njëmijëetëqindekatërdhjetëepesë euro e nëntëdhjetëegjashtë cent) me kamatë ligjore prej 8% në V., prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tësit Elbasan Emërllahu, për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,393.18 euro (dymijëetreqindenëntëdhjetëetë euro e tetëmbdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses Afërdita Murtezi, për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,462,06 euro (dymijëekatërqindëgjashtëdhjetëdy euro e gjashtë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses Flamire Alidema, për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,671,73 euro (dymijëegjashtëqindeshatatëdhjetënjë euro e shtatëdhjetëetë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses F.N., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022 shumën prej 2,513,85, euro (dymijëepesqindetrembdhjetë euro e tetëdhjetë e pesë cent) me kamatë ligjore prej 8%, në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tësit H.H., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,466,56 euro (dymijë ekatërqind egjashtëdhjetëegjashtë euro e pesëdhjetëe gjashtë cent) me kamatë ligjore prej 8%, në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses H.P., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,376,61 euro (dymijëetreqindështaëdhjetëegjashtë euro e gjashtëshjetënjë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës

kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses L.H., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,524,60 euro (dymijëpesqindenjzetekatër euro e gjashtëdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses M.M., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,127,54 euro (dymijënjëqindenjzeteshtatë euro e pesëdhjetëekatër cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses N.I., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,579,72 euro (dymijëpesëqindeshatëdhjetenëntë euro e shtëdhjetëedy cent) me kamatë ligjore prej 8%, në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses K.R., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,739,46 euro (dymijëeshtatëqindetridhjetëenëntë euro e katërdhjetëegjishtë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tësit R.I., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,513,19 euro (dymijëpesëqindetrembdhjetë euro e nëntëmbdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8%, në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tësit R.P. për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 1,611,07 euro (njëmijë gjashtëqindnjëmbdhjetë euro e shtatë cent) me kamatë ligjore prej 8%, në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses V.S.për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,755,55 euro (dymijëeshtatëqindpesëdhjetëepesë euro e pesëdhjetëepesë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

-Padi tëses Dr.D.H., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 3,113.16 euro (tremijënjëqindetremdhjetë euro e gjashtëmbdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi

-Padi tëses Dr. S.Z., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2022, shumën prej 2,259.60 euro (dymijëedyqindesëdhjetëenëntë euro e gjashtëdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

-Padi tëses Dr. S.A., për periudhën prej 11 shkurt/2014 deri më 31.12.2015, shumën prej 411.84 euro (katërqindnjëmbdhjetë euro e tetëdhjetekatër cent) me kamatë ligjore prej 8% në vit, prej 01.01.2023, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për pagesën e shpenzimeve të ekspertizës financiare në shumë prej 71.00 euro të gjitha këto në afat prej 7. dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

II. Konstatohet e tërhequr padia e padi tësve I.H. dhe Dr. F.A., e ushtruar kundër të paditurës Komuna e V.- Drejtoria për Sëndetësi dhe Mirëqenje Sociale për shkak të kontestit Kompensimi i orëve të kujdestarisë, orëve gjatë natës, jashtë orarit, gjatë festave dhe fundjavës .

III.Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore

A r s y e t i m

Padi tësit A.K., K.R., N.I., I.H., M.G., B.E., M.I., L.H., H.H., Dr.F.A., R.P., F.N., A.N., B.B., dhe në fazat e mëvonshë të procedurës përmes parashtrësës për rregullimin-precizimin e kërkespadi së te dates 12.02.2024, është bërë precizimi bazuar në ekspertizën financiare të ekspertit të licencuar gjyqësor Mr.Sc. I.T., për secilin padi tës që tua kompensoj të ardhurat personale të papaguara të orve të kujdestarisë, orëve të punës gjat natës, orëve të punës jashtë orarit dhe të orëve të punës gjatë festave dhe fundjavëve duke ua paguar dhe ndryshimin e trustit pensional për shumën e aprovuar të kërkespadi së në periudhën kohore 11.02.2014 deri në 31.12.2022, në shumën e përgjithëshme prej 47,180.29 € (dyzeteshtatmijë e njëqindetëdhjetë euro e njëzetë e nëntë cent), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Lidhur me këtë qështje kontestimore, Gjykata Themelore në Gjilan Dega në V., me Aktgjykimin C.nr.38/2017, të dates 28.09.2018, ka refuzuar kërkespadi në e padi tësve si të parashkruar.

Përfaqësuesi i auorizuar i padi tësve av. E.P., pas pranimit të Aktgjykimit C.nr.38/2017, të dates 28.09.2018, të Gjykatës Themelore në Gjilan Dega në V., ka paraqitur ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosoves, duke vendosur, lidhur me ankesën e paraqitur nga përfaqësuesi i padi tësve av.E.P., me Aktvendimit me nr.Ac.nr.4400/2018, date 23.07.2021, e ka aprovuar

ankesen e përfaqësuesit të paditësve dhe Aktgjykimin me nr.38/2017 të dates 28.09.2018, të Gjykatës Themelore në Gjilan Dega në V., e ka prishur dhe çështjen e ka kthyer në gjykatën e shkallës parë në rivendosje.

Gjykata Themelore në Gjilan Dega në V., përkatsisht gjyqtari i cili është ngarkuar më lëndën e kthyer në rivendosje, me date 21.11.2022, ka caktuar dhe mbajtur senacen përgaditore, ku kanë prezentuar përfaqësuesi i paditësve av.E..nga V. dhe përfaqësuesi ligjor i të paditues avokati publik i komunës së V. - I.R..

Përfaqësuesi me autorizim i paditësve av. E.P. në këtë séance përgaditore të datës 21.11.2022, ka deklaruar, se fillimisht mbetet pranë padisë dhe kërkespadiës, ndersa për paditësin I.H. e terheq padinë dhe kërkespadinë, poashtu ka bërë precizimin e kërkespadiës për nga koha lidhur me kompensimin e të ardhurave personale të pa paguara në emër të të orëve të kujdestarisë, orëve të punës gjat natës, orëve jashtë orarit dhe të orëve gjatë festave dhe fundjavëve dhe atë që nga data 11.02.2014, deri ne përpilimin e ekspertizes financiare, gjithëashtu i ka propozuar gjykatës të të caktoj një ekspert finaciari, i cili do të llogaritë shumën mjeteve te pa paguara paditësve, në emër të orëve të kujdestarisë, orëve të punës gjat natës, orëve jashtë orarit dhe të orëve gjatë festave dhe fundjavëve, për secilin paditës veq e veq, ndërsa pas pranimit- marrjes se ekspertizes financiare e dates 31.05.2023, ka kërkuar që e njehta ekspetizë të plotesohet edhe për paditësin Dr.F.A., për të cilin nuk është llogaaritur shuma e mjeteve të pa paguara në emër të orëve të kujdestarisë, orëve të punës gjat natës, orëve jashtë orarit dhe të orëve gjatë festave dhe fundjavëve.

Përfaqësuesi ligjor i të paditues I.R., në seancen pregaditore të datës 21.11.2022, ka deklaruar se fillimisht mbetet pranë përgjegjjes në padi nga se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është parashkruar, në procedurë të rivendosjes në bazë të rekomandimeve së Gjykatës së Apelit, përfaqësuesi i paditësve, bëri precizimin e kërkespadiës përkatësisht ndryshoj- e konsideroj se është parashkruar nga data 11.02.2011 deri 11.02.2014, ndersa kërkesëpadinë e precizoj nga data 11.02.2014 e tutje deri në vendeje, këtë precizim e kundershtoj me arsyetimin se e paditura i posedon të gjitha regjistrat një nga një, ka kërkuar që si dëshmitar të ndëgjohet shefi i kontabilitet tek e paditura A.A..

Gjykata sipas propozimit të përfaqësusit të paditësve, me aktvendimin C.nr.764/2021, të dates 21.11.2022, ka caktuar si ekspert gjyqsor financiar ecc. e diplomuar I.T.nga Gilani, ekspert i licencuar nga KGJK-ja, që të bëjë kalkulimin-llogaritjen e shumave financiare e të pa paguara, në emër të kompenzimit të orëve të kujdestarisë, orëve të punës gjat natës, orëve jashtë orarit dhe të orëve gjatë festave dhe fundjavëve, për të gjithë paditësit veq e veq, duke filluar nga preudha 11.02.2014 deri në datën e përpilimit të ekspertizës.

Përfaqësuesi i paditësve, pas pranimit të ekspertizës financiare, me datën 12.02.2024, me parashtrësë ka bërë rregullimin e padisë-kërkespadiës, ashtu që vlera e kontestit është përcaktuar në shumë prej 47,180.29 euro.

Gjykata me date 13.02.2024 lidhur me këtë qështje ka mbajtur shqyrtimin kryesor ku kanë prezentuar përfaqësuesi i paditësve me autorizim të bartur av. F.P. nga V. dhe përfaqësuesi ligjor i të paditues A.A. nga V. si dhe eksperti financiar I.T..

Përfaqësuesi i paditësve me autorizim të bartur, av. F.P. në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 13.02.2024, ka deklaruar: se fillimish ka hequr dorë nga padia për paditësin Dr.F.A., pasi që i njëjti nuk kishte qenë i punësuar në mënyrë të rregullt tek e paditura, gjithashtu ka propozuar që fjalën përfundimtare ta dorëzojnë me shkrim.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve av. E.P., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me parashtresë me date 20.02.2024, ka deklaruar: Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës kryesore të datës 13.02.2024. në të cilën janë administruar të gjitha provat ka kërkuar nga Gjykata që të aprovoj kërkespudinë e paditësve, si në parashtresën dorëzuar në gjykatë me datë 12.02.2024, sipas të cilës parashtresë kemi kërkuar që Gjykata të aprovoj kërkespudinë e paditësve lidhur me kompenzimin e orëve të kujdestarisë, orëve të punës gjatë natës, orëve jashtë orarit dhe të orëve gjatë festave dhe fundjavëve, për periudhën kohore shkurt 2014 deri me datën 31.12.2022, për të cilën periudhë eksperti financiar kishte llogaritur shumën e papaguar nga e paditura. Nga provat e administruara nuk është kontestuese që të gjithë paditësit janë puntorë të e paditura dhe kanë punuar të e paditura edhe para muajit shkurt të V. të 2014. Të gjithë paditësit kanë qenë në njësinë e kujdestarisë të Shtëpisë Shendetit në V. dhe kanë realizuar të ardhura personale, por nuk ka qenë e llogaritur sipas Kontrates së Punes, Ligjit të Punes (Ligji nr. 03/L-212) Kontrates Sektoriale të Shendetesise dhe Aktin e Brendshëm të Shendetesise. Të gjithë paditësit si të punësuar kanë pasur normën e punës të caktuar prej 160 orëve të punës në muaj, ka ndodhur që nuk kanë mundur të mbahen të gjitha orët e punës nga arsyeja se orarin e punës i bërë-perpiluar nga punëdhësi që e ka pasur për obligim që të krijoj mundësinë që secili puntor të plotësojë normën e punës prej 160 orëve të punës në muaj, por për shkak të angazhimit të puntoreve të tjere që kanë punuar me ndermjetësimin e Shoqatës Caritas Kosova, sipas marrëveshjes me Komunën e V., pagesën e ketyreve të pranuarve në punë me kontrata të perkohshme e ka bërë Shoqata Caritas Kosova e jo Komuna, e që me angazhimin në punë të të njëjtesve, paditësve iu ka pamundësuar pa dashjen e tyre mbajtja e 160 orëve në muaj. Me Ekspertizën financiare nuk është llogaritur paga shtese e paraparë në nenin 56 të Ligjit të Punes, në pajtim me këtë Ligj dhe Kontraten Kolektive, ku sipas paragrafit 2 të këtij ligji paga shtese në përqindje të pagës bazë është dashur të llogaritet 20% për orë të kujdestarisë, 30% për orë për punën gjatë natës, 30% për orë të punës jashtë orarit, 50% për orët e punës gjatë festave dhe 50% në orë për punën gjatë fundjavës. Nëse shiqohet Ekspertiza financiare në tabelat e paraqitura shihet se fare nuk janë llogaritur paga shtese në përqindje (%) të pagës bazë të pagës prej 20% në orë për kujdestari por vetëm janë llogaritur paga shtese në përqindje prej 50% dhe 30%. Sipas kësaj Ekspertize numëri i orëve të rregullta të munguara të puntorëve të QKMF në V.-paditësve, janë plotësuar nga numëri i orëve të punës gjatë natës dhe të orëve shtese që realisht kjo nuk ka qenë e drejtë e punëdhësit nga arsyeja se se pari nuk u ka mundësuar puntorëve që për çdo muaj me orar të punës të mbulohet mundësia e punës prej 160 orëve në muaj, e gjithashtu numëri i orëve të rregullta të munguara nuk mund të plotësohet nga numëri i orëve të punës gjatë natës dhe orëve shtese që llogariten si paga shtesë, si përqindje të pagës baze. Për secilin paditës ekspertin në mënyrë të veçantë ka llogaritur shumën e mjeteve që janë shuma që nuk u janë paguar puntoreve për shkak se punëdhësi i ka mbuluar orët e rregullta mujore prej 160 orëve në muaj. E paditura me mosmenaxhimin e drejtë për shpërndarjen e orëve të punës dhe plotësimin e tyre sipas kontratave të punës, qëllimisht nuk

ua ka plotesuar normen e plotë të punës punetoreve me orar të punës, nuk ua ka paguar fare orët e kujdestarise sipas të drejtës në pagë shtesë nga nenit 56 të Ligjit të Punës, me çka paditesve nuk iu është dhënë paga shtesë e paraparë me Ligj dhe Kontratë Kolektive. Veprimi i njëanshem i të paditësve dhe plotesimi i numërit të orëve të rregullta dhe të munguara të puntoreve nga numëri i orëve të punës gjatë nates është shkelje e të drejtave të puntoreve në mënyrë të njëanshme nga punedhësi, nga arsyeja se puntoret me kualifikime të njëjta që kanë punuar vetëm në orët e rregullta të punës, pa benifite të pagave shtesë sipas nenit 56 dhe që nuk kanë punuar gjatë festave, fundjavave, në orarin e punës së nates kanë realizuar paga të njëjta si edhe puntoret që kanë punuar me orar të punës 07-15 të dites. Nga të theksuarat kerkoj nga Gjykata që të aprovoj kërkesëpadinë e paditesve si të bazuar, të paraqitur në mënyrë individuale për secilin paditës veç e veç si në parashtrësen për rregullimin-precizimin e kërkesëpadisë të datës 12.02.2024 si dhe të Obligoj të paditësit që të autorizuarit të paditesve të ia paguaj shpenzimet e perfaqsimin të paditesve në shumë të përgjithshme prej 4,068.50 euro dhe atë për: përpilimin e paditësve shumen prej 624.00 euro, për Ankesën kundër Aktgjykimit të shkallës së parë 624.00 euro për 3 (tri) seanca gjyqësore nga 811.00 euro perkatesisht 2,433.00 euro dhe për një seancë të shtyer me kërkesën e të paditësve pa fajin e perfaqësuesit të paditesve dhunen prej 405.50 Euro të gjitha keto sipas TOAK.

Përfaqësuesi ligjor i Komunës V.- të paditësve, A.A., në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 13.02.2024 ka deklaruar: ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, lidhur me pagesën e orëve shtesë të papaguara për periudhën kohore 2014 deri 31.12.2022 me arsyetimin se të njëjtat u janë paguar. Ndërsa në fjalën përfundimtare të dorzuar me shkrim në këtë gjykatë me parashtrësen e datës 16.02.2024, i njëjti ka mbatur pranë kundërshtimeve të paraqitura në seancë gjyqësore dhe ka shtuar se për palët nuk ishte kontestuese fakti se paditësit janë në marrdhënie pune në QKMF-ë në V., po ashtu nuk ishte kontestuese as ekspertiza e punuar nga eksperti financiar I.T., në të cilën ekspertizë janë të listuara të gjitha orët shtesë të paditësve, e po ashtu edhe pagesat për orët shtesë të cilat i ka paguar Komuna e V., ku për këtë nuk pati kundërshtime as përfaqësuesi i paditësve. Sipas ekspertizës financiare, vërehet se psh: paditësit se parë A.K., përveç pages, i janë paguar 5.800.00 euro për orët shtesë për preudhën e cekur në ekspertizë, ndërsa orët e tjera shtesë i janë bartur për të mbuluar orët e rregullta të orarit të plotë të punës, siq parasheh edhe Ligji i Punës (40 orë) në javë, ku paditësit nuk i është humbur asnjë orë pune, por orët i janë bartur në atë mënyrë që vetëm të arrihet kuota prej 160 orëve punë gjatë muajit, ndërsa pjesa tjetër i është paguar në tërësi nga e paditura, siq shihet edhe në konstatimin e ekspertit financiar të specifikuar në ekspertizë, fakt ky i pa kontestuar nga përfaqësuesi i paditësve. Në konstatimin e ekspertit financiar, vërehet se të çdo paditës, e paditura i ka përmbushur detyrimet e veta siq përcaktohet me ligj, sa i përket orëve shtesë, janë ato orët të cilat janë transferuar në orët e rregullta të punës të secilit paditës, në mënyrë që të plotësohet orari i plotë i punës i paraparë me ligj. Me këto orë të transferuara, paditësit e kanë marrë pagën e rregullt bazuar në kontratën e tyre si dhe shtesat për orët shtesë. Te të gjithë paditësit është rasti i njëjtë dhe vlen arsyetimi i njëjtë, andaj nuk do të lëshohemi për secilin paditës veç e veç. Sipas Ligjit të Punës, nenit 24.1 përcaktohet se “*Ndarjen e orarit të punës në kuadër të javës së punës e përcakton punëdhënësi*”, ndërsa në paragrafin 2. të të njëjtit nen parashihet se “*Java e punës mund të organizohet ndryshe, në rast se punëdhënësi e*

organizon punën me ndërrime, gjatë natës ose kur natyra e punës e kërkon një gjë të tillë”, ndërsa në nenin 25.1 theksohet *“Punëdhënësi, mund ta ndryshojë orarin e punës kur e kërkon natyra e punës, si: organizimi i punës, shfrytëzimi racional i mjeteve të punës, shfrytëzimi racional i orarit të punës dhe kryerja e ndonjë pune të caktuar dhe të parashikuar me afat”,* që do të thotë se sipas ligjit, punëdhënësi mund ta ndryshojë orarin e punës në mënyrë që të arrihet një shfrytëzim racional i orarit të punës dhe të arrihet orari prej 40 orë pune në javë siç parasheh ligji, kjo edhe për arsye se siç dihet, puna në institucione shëndetësore kërkon orar të përshtatshëm për shkak të natyrës së punës, poashtu, sipas nenit 56.1 të Ligjit të Punës përcaktohet *“Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës”,* pra, kjo dispozitë rregullon se vetëm puna me orar më të gjatë se orari i plotë do të llogaritet si punë shtesë dhe do të paguhet si pagë shtesë sipas ligjit, ku në rastin e të gjithë paditësve, puna për orët shtesë, jashtë orarit të plotë të punës është paguar në tërësi nga e paditura, gjë që nuk ka qenë kontestuese nga përfaqësuesi i paditësve, si dhe ka qenë fakt i konstatuar edhe në ekspertizë. Kontestuese për palët ka qenë vetëm baza ligjore se a i takojnë shtesat në pagë edhe për ato orë të cilat janë bartur për mbulimin e orarit të rregullt të punës, që sipas të paditurës këto shtesa nuk i takojnë, pasi në dispozitën e cekur më lart përcaktohet me saktësi se këto shtesa i takojnë të punësuarit për punën e kryer më të gjatë se orari i plotë i punës, që nënkupton se i punësuari së pari duhet që t’i ketë të arritura orët e rregullta të orarit të punës, e pastaj të bëjë punë shtesë, e jo si në rastin konkret të paditësve që me qëllim të përfitimit të një page sa më të lartë, kanë punuar orë shtesë, pa i arritur fillimisht orët sipas orarit të rregullt të punës, që sipas Ligjit të Punës duhet të jenë 40 orë në javë apo 160 orë në muaj. Po ashtu, sipas të paditurës, e po ashtu edhe sipas konstatimit të ekspertit, paditësit veçse janë paguar për kërkesat e pretenduara, andaj në rast të aprovimit të kërkesëpadiisë do të kishte pasurim të pabazë nga ana e paditësve, sepse do të përfitonin dy herë shtesa për pagat tashmë të paguara, pasi ato orë të cilat janë transferuar në orët e rregullta të orarit të punës si dhe ato orë që kanë mbetur, janë paguar me pagën e marrë së bashku me shtesat. Andaj, nga të lartcekurat, e kundërshtojmë në tërësi kërkesëpadiinë e paditësve si të pabazuar në ligj dhe i kërkojmë gjykatës që pas administrimit dhe vlerësimit të provave, këtë kërkesëpadi ta refuzojë si të pabazuar dhe të pathemeltë, rrjedhimisht edhe shpenzimet e procedurës, pasi kjo padi nuk ka asnjë bazë ligjore.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë në këtë çështje gjykata bëri administrimin dhe shtjellimin e provave materiale dhe personale edhe ate: ankesa e datës 16.09.201, drejtuar Drejtorisë për Mirqenie Sociale, njoftimin e dt.10.10.2018 me nr.251 nga Shefi i financave pran QKMF A.A. dhe ekspertiza e ekspertit financiar I.T.e dt.18.05.2023.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-ës dhe në bazë të rezultatit të procedurës së zhvilluar kontestimore Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se paditësit kanë punuar dhe punojn në institucionin shëndetsor Shtëpia e Shëndetit në V., dhe se norma e orëve për një muaj është 160 orë, meqenëse nuk është aritur numri i orëve të punës së mbajtur në muaj prej 160 orëve, të njejtëve nga QKMF në V., orët e munguara iu janë plotësuar duke përfshirë orët e punës gjatë kujdestarisë, orët e punës gjatë natës, orët e punës gjatë festive dhe, gjatë fundjavës siq janë të parapar në kontratë punës.

Nga deklarimi i ekspertit financiar I.T. nga Gjilani, në seancën kryesore të datës 13.02.2024, ku i njeti është deklaruar se ekspertizën financiare e kishte hartuar duke u mbështetur në vendimin e GJTH-Gjilan dega në V., përkatësisht në detyrat e dhëna në aktvendim, sipas aktvendimit kishte për detyrë që të kalkulonte shumën financiare të papaguar në emër të kompensimit të orëve të punës gjatë kujdestarisë, orëve të punës gjatë natës, orëve të punës jashtë orarit, orëve të punës gjatë festive dhe fundjavës për të gjithë paditësit, nga materialet që kishte siguruar nga Drejtoria për Shëndëtsi dhe Mirqenje Sociale në V.-Zyra e Financave, kishte siguruar të gjitha të dhënat e nevojshme për hartimin e ekspertizës për secilin paditës veç e veç të cilat edhe i ka paraqitur në ekspertizën financiare, të dorëzuar në Gjykatë me datë 31.05.2023, eksperti financiar ka mbetur në tërsi pranë ekspertizës financiare. Në pyetjen e përfaqësuesit të paditësve, eksperti financiar I.T., është përgjigjur se; në çoftë se puntori do të kishte mbajtur 160 orë dhe do të paguhej, atëherë diferenca do të ishte siq është llogaritur në ekspertizë, mirpo meqenëse punëdhësi plotësimin e orëve të munguara të normës prej 160 orëve, e ka plotësuar me orët e kujdestarisë, orëve të punës gjatë natës, orëve të punës jashtë orarit, orëve të punës gjatë festive dhe fundjavës, kështë që edhe iu ka paguar duke i bartur orët shtesë në orë të rregullta, të cilat edhe financiarisht i ka paguar, siq e kam cekur në ekspertizë. Ndërsa në pyetjen e përfaqësuesit të të paditësve ekspertit financiar është përgjigjur se; në bazë të ekspertizës të hartuar për secilin paditës, e paditësi i ka kompensuar paditësit për orët shtesë duke i plotësuar fondin e orëve të rregullta sipa ligjit që janë 160 orë në muaj, meqenëse, paditësit nuk kanë pasur të mbajtur orët sipas ligjit prej 160 orëve në muaj, të njejtëve-paditësve u janë plotësuar me orët e kujdestarisë, orëve të punës gjatë natës, orëve të punës jashtë orarit, orëve të punës gjatë festive dhe fundjavës dhe pas plotësimit ato edhe janë kompensuar, kështë që si përfundim e paditura i ka kompensuar paditësit në atë mënyrë që orët shtesë janë shpërndarë, përkatësisht janë bartur në plotësimin e normës së rregullt prej 160 orëve punë në muaj. Në pyetjen e gjyqtarit, eksperti ka deklaruar se; shumën e papaguar të llogaritura sipas ekspertizës për secilin paditës, siq e kam cekur në pasuesin e fundit për secilin paditës, janë shumën të cilat nuk janë paguar pasi që të njejtat janë inkorporuar në pagën e përgjithëshme duke e plotësuar fondin e orëve prej 160 orëve në muaj sepse paditësit kanë pasur dallime në orët e mbajtura, dikush me shumë e dikush me pak, por nuk e kanë pasur të plotësuar fondin e orëve prej 160 orëve në muaj, prandaj punëdhësi fondin e orëve shtesë e ka shpërndarë sipas muajëve dhe viteve tek secili paditës.

Nga ankesa e datës 16.09.2015, drejtuar Drejtorisë për Mirqenie Sociale, gjykata vërtetoi faktin se paditësit me datë 16.09.2015 kanë ushtruar ankesë ndaj përgjegjes, lidhur me kërkesën për kompensimin e orëve shtesë.

Nga njoftimin e dt.10.10.2018 me nr.251, nga Shefi i financave pran QKMF A.A., gjykata vërtetoi faktin se paditësve nuk ju takon kërkesa për kompenzimin e orëve shtesë, nga se të njejëve ju janë mbuluar me orët e rregullta.

Nga administrimi i ekspertizës financiare në cilësinë e provës materiale gjykata ka gjetur se në bazë të tabelave, shifet se punëtorëve ju janë bërë pagesat e punës shtesë në shumat përkatëse sipas kontrates së punës kështë që për paditësen Ajten Kamberi, shuma e mjeteve prej 2,479.30 euro, është shuma e cila nuk i është paguar, për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orë në muaj, për paditësin K.R., shuma prej 2,137.90 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen M.I., shuma prej 513.19 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen M.G., shuma prej 2,684.58 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësin B.E., shuma prej 1,845.96 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësin Elbasan Emërllahu, shuma prej 2,393.18 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen Afërdita Murtezi, shuma prej 2,462.06 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen Fatmire Alidema, shuma prej 2,671.73 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen F.N., shuma prej 2,513.85 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësin H.H., shuma prej 2,466.65 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen H.P., shuma prej 2,376.61 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen L.H., shuma prej 2,524.60 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen Muzaffer Musliu, shuma prej 2,127.54 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen Nesibe Ismajli, shuma prej 2,579.72 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen K.R., shuma prej 2,739.46 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësin R.I., shuma prej 2,613.19 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësin R.P., shuma prej 1,611.07 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen Vjollca Sylejmani, shuma prej 2,755.55 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen D.H., shuma prej 3,113.16 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj, për paditësen Servime Zuka, shuma prej 2,529.60 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj dhe për paditësen

Shqiponia Abdyli, shuma prej 411.84 euro, është shuma e cila nuk i është paguar për shkak të mbulimit të orëve të rregullta mujore prej 160 orëve në muaj.

Gjykata ekspertizën financiare e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë dhe të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme, sepse nga kjo ekspertizë është vërtetuar se e paditura, mungesën e orëve të rregullta për normën mujore prej 160 orëve në muaj, të paraparë sipas ligjit, të njejtëve-paditësve ua ka plotësuar me orët e kujdestarisë, orëve të punës gjatë natës, orëve të punës jashtë orarit, orëve të punës gjatë festave dhe fundjavës dhe pas plotësimit të normës prej 16 orëve në muaj, ato edhe u janë kompensuar secilit paditës veq e veq.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe provat tjera materiale të përmendura më lartë, por ato ishin irelevante në vendosjen meritorë të kësaj çështje, ashtu që nuk u arsyetuan veç e veç.

Gjykata pas analizimit dhe shtjellimit të gjitha provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse e refuzoi kërkesë padinë e paditësve si të pabazuar, për kompensimin e shumës prej 47,180.29 €, në emër të orëve shtesë kujdestarisë, orëve të punës gjatë natës, orëve të punës jashtë orarit, orëve të punës gjatë festave dhe fundjavës, pasi që në bazë të Ligjit të Punës me nr. Ligji Nr. 03/L-212 dhe në bazë të Kontrata Kolektive Sektoriale për shëndetsinë, të gjithë puntorët shëndetsor në tërë Republikën e Kosovës kanë për obligim të mbajnë 40 orë pune brenda javës, përkatësisht 160 orë pune në muaj, e që në rastin konkret, paditësit nuk e kanë plotësuar kuoten e orëve prej 160 orëve të punës në muaj për normë të plotë të punës, kështu që pundhënsi me orët e punës gjatë kujdestarisë, orët e punës gjatë natës, orët e punës gjatë jashtë orarit, orët e punës gjatë festave dhe fundjavës, të papaguara për periudhen kohore 11.02.2014 deri me 31.12.2022, në bazë të ekspertizës financiare të gjithë paditësve iu është plotësuar norma prej 160 e orëve të punës, me orët e punës gjatë kujdestarisë, orëve të punës gjatë natës, orëve të punës gjatë jashtë orarit, orëve të punës gjatë festave dhe fundjavës, kështu që;

-për paditësen A.K., 1072 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është $365 \text{ orë} \times 2.26\text{€/orë} = 824.90\text{€}$ dhe nga V. 2018-31.12.2022 është $704 \text{ orë} \times 2.35\text{€/orë} = 1,654.40\text{€}$ që gjithsej është 2,479.30€,

-për paditësin K.R., 922 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është $320 \text{ orë} \times 2.26\text{€/orë} = 723.20\text{€}$ dhe nga V. 2018-31.12.2022 është $602 \text{ orë} \times 2.35\text{€/orë} = 1,414.70\text{€}$ që gjithsej është 2,137.90€.

-për paditësen M.I., 922 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është $199 \text{ orë} \times 2.26\text{€/orë} = 449.90 \text{ euro}$ dhe nga V. 2018-31.12.2022 është $704 \text{ orë} \times 2.35\text{€/orë} = 1,654.40\text{€}$ që gjithsej është 2,479.30€,

-për paditësen M.G., 1158 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 408 orë x 2.26€/orë = 922.08 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 750 orë x 2.35€/orë = 1,762.50€ që gjithsej është 2,684.58€,

-për paditësin B.E., 1158 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 326 orë x 2.26€/orë = 736.76 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 472 orë x 2.35€/orë = 1,109.20€ që gjithsej është 1,845.96€,

-për paditësin Elbasan Emerllahu, 1092 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 466 orë x 2.26€/orë = 922.08 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 626 orë x 2.35€/orë = 1,471.10€ që gjithsej është 2,393.18€,

-për paditësen Afërdita Murtezi, 1064 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 426 orë x 2.26€/orë = 962.76 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 638 orë x 2.35€/orë = 1,499.30€ që gjithsej është 2,462.06€,

-për paditësen Flamire Alidema, 1158 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 368 orë x 2.26€/orë = 831.68 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 783 orë x 2.35€/orë = 1,840.05€ që gjithsej është 2,671.71€,

-për paditësen F.N., 1026 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 411 orë x 2.26€/orë = 1,068.60 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 615 orë x 2.35€/orë = 1,445.25€ që gjithsej është 2,513.85€, për

paditësin H.H., 1064 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 376 orë x 2.26€/orë = 849.76 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 688 orë x 2.35€/orë = 1,616.80€ që gjithsej është 2,466.56€,

-për paditësen H.P., 1024 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 331 orë x 2.26€/orë = 748.06 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 693 orë x 2.35€/orë = 1,693.55€ që gjithsej është 2,376.61€,

për paditësen L.H., 1090 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura

është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 410 orë x 2.26€/orë = 926.60 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 680 orë x 2.35€/orë = 1,598.00€ që gjithsej është 2,524.60€,

-për paditësen Muzafer Musliu, 409 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 409 orë x 2.26€/orë = 924.34 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 512 orë x 2.35€/orë = 1,203.20€ që gjithsej është 2,127.54€,

-për paditësen N.I., 1112 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 372 orë x 2.26€/orë = 840.72 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 740 orë x 2.35€/orë = 1,738.00€ që gjithsej është 2,579.72€,

-për paditësen K.R., 1183 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 451 orë x 2.26€/orë = 1,019.26 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 732 orë x 2.35€/orë = 1,720.20€ që gjithsej është 2,739.46€,

-për paditësin R.I., 930 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 359 orë x 2.26€/orë = 811.34 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 571 orë x 2.35€/orë = 1,341.85€ që gjithsej është 2,153.19€,

-për paditësin R.P., 691 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 142 orë x 2.26€/orë = 320.92 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 549 orë x 2.35€/orë = 1,290.15€ që gjithsej është 1,611.07€,

-për paditësen Vjollca Sylejmani, 1194 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 455 orë x 2.26€/orë = 1,028.30 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 735 orë x 2.35€/orë = 1,727.25€ që gjithsej është 2,755.55€,

-për paditësen D.H., 767 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 293 orë x 3.96€/orë = 1,160.28 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 474 orë x 4.12€/orë = 1,952.88€ që gjithsej është 3,113.16€,

-për paditësen Servime Zuka, 734 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2017 është 416 orë x 3.39€/orë = 1,410.24 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 318 orë x 3.52€/orë = 1,119.36€ që gjithsej është 2,529.60€ dhe për

-për paditësen Shqiponia Abdyli, për 104 orë pune, nuk i janë paguar për shkak se të njejtat orë i janë llogaritur për të plotësuar normën e rregullt të punës prej 160 orë në muaj dhe se vlera e orëve të zbritura është nga V. 2014 deri me 31.12.2015 është 104 orë x 3.39€/orë =411.84 euro dhe nga V. 2018-31.12.2022 është 0.00€/orë gjithsej është 411.84 €.

Andaj shumata e mjeteve financiare të llogaritura sipas ekspertizës financiare, janë shumata financiare të cilat janë të inkoporuara në pagën e përgjithëshme, duke e plotësuar fondin e orëve për normë të plotë të punës prej 160 orëve në muaj, sepse paditësit në bazë të ekspertizës financiare, kishin pasur dallime në orët e punës sa i perket norms se plotë prej 160 orëve në muaj pasi q, asnjëri nuk e kishte të plotësuar fondin e orëve prej 160 orëve në muaj të kërkuara për një normë të plotë të punës për muaj, e që në këtë rast punëdhënsi, perkatësisht e paditura, orët e punës të paditësve të mbajtura gjatë kujdestarisë, orëve të punës gjatë natës, orëve të punës jashtë orarit, orëve të punës gjatë festave dhe fundjavës, i ka shpërdarë në muaj duke e bërë plotësimin e normës prej 160 orëve në muaj, të cilat pastaj edhe ia ka kompenzuar secilit paditës, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar me ekspertizën financiare e punuar nga eksperti financiar i licencuar nga KGJK-ja I.T.nga Gjilani, të cilës ekspertizë ia fali besimin e plotë, kështu që gjykata erdhi në përfundim e paditura i ka kompenzuar paditësit në atë mënyrë që orët shtesë janë shpërndarë, perkatësisht janë bartur në plotësimin e normës së rregullt prej 160 orëve punë në muaj për secilin paditës veq e veq.

Gjykata duke u bazuar në nenin 24.1 , i cili ka paraparë se „*Ndarjen e orarit të punës në kuadër të javës së punës e përcakton punëdhënësi* ’’, ndërsa në paragrafin 2 po të këtij neni është paraparë se ‘*Java e punës mund të organizohet ndryshe, në rast se punëdhënësi e organizon punën me ndërrime, gjatë natës ose kur natyra e punës e kërkon një gjë të tillë*’’, ndërsa në nenin 25, i po këtij ligji është paraparë se „*Punëdhënësi, mund ta ndryshojë orarin e punës kur e kërkon natyra e punës, si: organizimi i punës, shfrytëzimi racional i mjeteve të punës, shfrytëzimi racional i orarit të punës dhe kryerja e ndonjë pune të caktuar dhe të parashikuar me afat.*”.

Gjithashtu gjykata duke u bazuar në nenin 7 paragrafi 1, nenin 319.1 dhe nenin 322 pika 1 dhe 2 të LPK-ës, e që me nenin 7.1 është paraparë se ‘*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*’ me nenin 319.1, është paraparë se ‘*secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*’, kurse neni 322.1 ka paraparë se ‘*në qoftëse gjykata në bazë të provave të marrura (conform nenit 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës*’, ndërsa neni 322.2, ka paraparë ‘*pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj po qe se ligji nuk parasheh diç tjetër*’, andaj nga provat e administruara, siç thamë edhe më lartë, paditësit nuk kanë arritur të provojnë dhe bindin gjykatën me faktin se të njejtat-paditësit nuk janë paguar për orët e punës gjatë kujdestarisë, orëve të punës gjatë natës, orëve të punës jashtë orarit, orëve të punës gjatë festave dhe të fundjavëve, andaj gjykata, duke u bazuar në provat e

administruara, deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, deklarimit të ekspertit financiar dhe sidomos bazuar në ekspertizen financiare, të cilës gjykata ia fali besimin e plotë, ka ardhë në përfundim se e paditura nuk qëndron në obligim për të kompenzuar paditëst e lartshenuar në shumat e kërkuara, siq pretendojn me padi dhe kërkesëpadi, sepse e paditura me orët shtesë të paditësve ka bërë plotësimin e norms së plotë të punës për çdo muaj prej 160 orëve në muaj për secilin paditës, pasi që paditësit nuk e kanë pasur të plotësuar normën e rregullt të orëve prej 160 orëve, kështu që e paditura për të plotësuar normën e rregullt prej 10 orëve të punës, iu ka shpërndar orët shtesë secilit paditësdhe të njejtat orë janë u janë kompenzuar paditësve secilit veq e veq, bazuar në ekspertizen financiare dhe shpjegimeve të ekspertit financiar, prandaj vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar..

Sa i përket pikës II të këtij aktgjykimi përfaqësuesi i të paditësve në seancës përgaditore më date 21.11.2022, ka bërë tëheqjen e padisë në emër të paditësit Ibush Hajrizi nga se kishte kërkesë e vet paditësit, ndërsa në sencën kryesore me datën 13.02.2024, ka kërkuar që kërkespadia e paditësit Dr. F.A. kundër të paditurës të konstatohet e tërhequr, me arsyetim se i njejtë kishte qenë i punsuar në Shtëpinë e shendetit në V., përmes shoqatës "Caritasit Kosova".

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 261, të LPK-së, ka vendosur si në dispozitivin II të këtij Aktgjykimi, ngase në dispozitivin përkatës është i mundur një veprim i tillë procedural, respektivisht në nenin 261 të LPK-së shprehimisht është përcaktuar se „ *Paditësi mund të tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi. Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 452.4 të LPK-ës, pasi që paditësit edhe pse i kanë kërkuar shpenzimet gjyqësore dhe atë në shumë prej 4,068.50 euro, të njëjtit nuk kanë pasur sukses në kontest, kurse përfaqësuesi ligjor i të paditurës nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga të cekurat më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS V.
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:908288, 13.02.2024
C. nr.764/2021**

**Gjyqtari
Alush Sinani**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.